



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PERGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1257/6prot.

Tiranë më 5.8.2022

**VENDIM**

Nr. 24, datë 5.8.2022

**PËR KONTROLLUESIN “DREAM MATTRESS” SHPK**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Dream Mattress” SH.P.K. (në vijim, “Kontrolluesi”),

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 108, datë 08.07.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), nga grupi i kontrollit, u krye hetimi administrativ pranë “Dream Mattress” SH.P.K. (në vijim, “Kontrolluesi”), me objekt:

- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga shtetasi \_\_\_\_\_, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

Kontrolluesi “Dream Mattress” SH.P.K., është person juridik, me NIPT: M21502016E, me status aktiv, i cili ofron shitje me pakicë dhe shumicë të artikujve shtëpiakë për klientët. Gjatë aktivitetit tregtar, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë “klientë”, “punonjës” dhe “vizitor”.

1. Duke ju referuar ankesës së shtetasit \_\_\_\_\_, në cilësinë e subjektit të të dhënave, ky i fundit, pretendon se, është telefonuar nga kontrolluesi, nëpërmjet numrit mobile

+355442 , për t'i bërë me dije ofertat e tij të artikujve shtëpiakë. Nga ana e tij, ankuesi nuk ka dhënë asnjëherë miratim paraprak, për marrjen e ofertave promotionale nga ky kontrollues.

Në këtë kuadër, me qëllim verifikimin e pretendimeve të ankuesit, nga hetimi administrativ rezultoi se, numri +355442 , i referuar nga ankuesi, është numër në përdorim të kontrolluesit, nëpërmjet të cilit është realizuar marketing i drejtpërdrejtë, në mënyrë të paligjshme. Në lidhje me bazën e të dhënave që përdoret nga kontrolluesi me qëllim marketingu, u konstatua se nuk ka një sistem të mirëfilltë të dhënash por, sipas deklarimeve të tij, përdoren numra të publikuar në motorin e kërkimit “Google”, për reklamim produktesh.

2. Kontrolluesi kryen marketing të drejtpërdrejtë, nëpërmjet numrave të telefonit sipas mënyrës së sipërcituar, por, për këtë qëllim nuk aplikon/provon marrjen e pëlqimit për të kontaktuar subjektet e të dhënave, duke vepruar në kundërshtim me germën “a” të pikës 1 të nenit 6 të Ligjit.

Ekzistenca e pëlqimit në këtë rast është e vetmja mundësi ligjore e kontrolluesit, referuar nenit 6 të Ligjit, për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale. Pëlqimi, në bazë të nenit 3 pika 24 të Ligjit, “...duhet të jetë në formën e një deklarate me shkrim, i dhënë shprehimisht me vullnet të plote e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plote për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, ç’ ka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin paraprak dhe të shkruar për përpunimin e të dhënave të tyre për qëllime marketingu, pavarësisht mënyrës së gjenerimit të të dhënave, është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të sanksionuar në germën “a” të pikës 1 të nenit 5 dhe me kriterin ligjor të përpunimit të sanksionuar në germën “a” të pikës 1 të nenit 6 të Ligjit.

3. Kontrolluesi disponon faqen online <https://dreammattress.al>. Konstatohet se, në faqe nuk është publikuar rubrika “Politikat e Privatësisë”, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave, personin që do t'i përpunojë, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare, si dhe të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të tyre, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo Kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë manuale apo elektronike, nëpërmjet faqes online në internet, ka detyrimin që të publikojë “Politikat e Privatësisë”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes online në internet. Informimi i subjekteve të të dhënave personale, sipas neni 18, është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi iu mundëson subjekteve të njihen me të drejtat që iu janë

akorduar me Ligj, si dhe iu mundëson, gjithashtu, ushtrimin e këtyre të drejtave në praktikë. Mos përmbushja e këtij detyrimi, nga ana e kontrolluesit, mund të sjellë pasoja sa i përket jetës private dhe bashkë me të, të drejtës së subjekteve të të dhënave për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale.

4. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejjimit (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme për qëllim të sigurisë së personelit dhe pronës. Konstatohet se, nuk janë vendosur tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video survejjimit (CCTV), në kundërshtim me parashikimin e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05/03/2010 të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 3*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezulton se, Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për “*Njoftim*” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjëse, në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për “*Njoftim*” mbi përpunimin e të dhënave personale, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe në realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

6. Kontrolluesi nuk ka hartuar “*Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike (mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale për çdo kategori subjekti të dhënash) sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, masat teknike dhe organizative etj., si dhe nuk ka nënshkruar deklaratë konfidencialiteti më punëmarrësit, në kundërshtim me nenin 27 dhe 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një “*Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, grupi i kontrollit hartoi procesverbalin i cili u lexua në prani të palëve. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ,

përfaqësuesi i Kontrolluesit nuk paraqiti kundërshtime dhe bashkëlidhur depozitoi pretendimet me shkrim.

Kontrolluesi, pas kryerjes së hetimit administrativ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit, Formularin e Njoftimit me nr. 1330 prot., datë 20.07.2022, i cili duhej të ishte kryer detyrimisht, para se subjekti të fillonte përpunimin e të dhënave personale, sipas nenit 21, 22 të Ligjit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është njoftuar që në datë 01.08.2022, të ushtrojë të drejtën e tij për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit pasi u paraqit në seancë dëgjimore, nuk pati kundërshtime me konstatimet e grupit të hetimit administrativ dhe depozitoi dokumentacion në lidhje me marrjen e disa masave me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore, të cilat dolën gjatë kontrollit dhe deklaroi se detyrimet nuk ishin përmbushur për shkak mos njohje të Ligjit. Zyra e Komisionerit, vlerëson se pretendimi nga ana e kontrolluesit, mbi mosnjohjen e ligjit nuk përbën shkak ligjor për moszbatimin e tij. Vlen të theksojmë se, Ligji Nr. 9887/ 2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", është një ligj i cili ka hyrë në fuqi dhe zbatohet, që prej vitit 2008.

Kontrolluesi, pas kryerjes së hetimit administrativ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit, Formularin e Njoftimit me nr. 1330 prot., datë 20.07.2022, i cili duhej të ishte kryer detyrimisht, para se subjekti të fillonte përpunimin e të dhënave personale, gjatë aktivitetit të tij, sipas neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Kontrolluesi, depozitoi "*Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", për të cilën, Zyra e Komisionerit vlerëson se është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike (mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në funksion të aktivitetit të tij, pasi akti i depozituar, ishte ai i publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit, i cili është një model i përgjithshëm dhe orientues për kontrolluesit. Në këto kushte ky akt është një dokument jo i vlefshëm për të adresuar mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nga ana e kontrolluesit.

Dokumentacion tjetër që ka depozituar kontrolluesi, janë masa të marra në drejtim të publikimit të Politikave të Privatësisë në portalin e Kontrolluesit dhe tabela informuese në ambientet e kontrolluesit, mbi prezencën e kamerave survejuese (CCTV), sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri, detyrime të cilat duhet të ishin plotësuar para fillimit të përpunimit të të dhënave personale dhe jo pas hetimit administrativ nga Zyra e Komisionerit.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39, pika 1, germet "a", "d" dhe "dh" të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka mbajtur parasysh faktin që, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, Zyra e Komisionarit, ka vlerësuar mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara, bashkëpunimin e tij me grupin e hetimit administrativ, si dhe merr në konsideratë pretendimin e kontrolluesit se, është në fazat fillestare të ushtrimit të aktivitetit të tij.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 21, 22, 27, 29, 30, 39 (pika 1, germat "a", "d" dhe "dh"), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

#### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në kreun II të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit;
3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit;
4. Kontrolluesi duhet të ndalojë menjëherë formën e aplikuar për përpunimin e të dhënave personale për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë;
5. Në vijim të detyrimit të parashikuar në pikën 4, të shkatërrojë në mënyrë të parikuperueshme të dhënat e mbledhura në mënyrë të paligjshme, për subjektet e të dhënave "jo klientë" (numrat e telefonit), të cilat përpunohen në kundërshtim me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të Ligjit. Në këtë kuadër, të mbajë evidenca për shkatërrimin;

6. Kontrolluesi në zbatim të nenit 21 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon në vazhdimësi;
7. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
  - (i) menjëherë, nga komunikimi i këtij akti, detyrimet e përcaktuara në pikën 4;
  - (ii) brenda 5 ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 5;
  - (iii) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 6 më sipër;Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;
8. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
9. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;
10. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 5.8.2022.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

